



Albanian-American
Development Foundation
www.aadf.org



www.cleanscore.al

THIRRJE PËR APLIKIME - KONKURSI PUNIMEVE KËRKIMORE - 3

Gjithmonë do të ekzistojë diçka e re dhe interesante për t'u zbuluar!

AADF nëpërmjet projektit CleanScore, ka mundësuar për universitetet publike partnere qasjen në librarinë digjitale JSTOR –www.jstor.org. Duke qenë një nga libraritë digjitale më të mëdha në botë, JSTOR u mundëson studentëve, stafit pedagogjik dhe hulumtuesve të fushave të ndryshme materiale në disiplinat dhe fushat e tyre të interesit.

CleanScore për të nxitur kërkimin shkencor cilësor, si dhe përdorimin e librarisë digjitale JSTOR, ka ndërmarrë iniciativën për të zhvilluar “**Konkursin Kombëtar të Punimeve Kërkimore – 3**”. Pjesëmarrja në këtë konkurs është e hapur për të gjithë studentët që ndjekin aktualisht studimet në të gjitha universitetet në Shqipëri dhe në universitetet Shqiptare në rajon. Punimet që do të pranohen në konkurs nuk kanë kufizim për fushën e studimit.


- Universiteti i Tiranës
- Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
- Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
- Universiteti “Fan. S. Noli”, Korçë
- Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
- Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
- Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë
- UET - Universiteti Europian i Tiranës
- Kolegji Luarasi
- Universiteti Mesdhetar i Tiranës

Në përfundim të konkursit do të shpallen fituesit dhe çmimet përkatëse:



Data të rëndësishme:

05 Dhjetor 2021 – 15 Maj 2022	Afati i dorëzimit të punimeve
15 Maj 2022 – 10 Qershor 2022	Seleksionimi dhe vlerësimi i punimeve
15 Qershor 2022	Shpallja e fituesve



www.jstor.org



www.akademia.al



KRITERET E APLIKIMIT & FORMATI I PUNIMIT

1. Kriteret e pranimit të punimeve:

- Punimi duhet t'i përmbahet rregullave të shkrimit akademik
- Punimi nuk duhet të përmbajë plagjiaturë, e cila do të kontrollohet nëpërmjet platformës Akademia.al
- Punimi kërkimor duhet të jetë argumentues
- Punimi duhet të përmbajë 2.500 – 3.000 fjalë
- Të paktën 50% e referencave në punim duhet të jenë nga JSTOR
- Punimi duhet të jetë në gjuhën shqipe

2. Kërkesa teknike për formatit:

- Faqosja (Layout): Formati i faqes: A4
- Shkrimi (Font): Times New Roman
- Hapësira e tekstit (Spacing): Double spaced
- Madhësia e shkrimit (Font size): 12 pt
- Hapësira e faqes (Margins): 2.5 cm në të katër drejtimet e faqes

3. Kapaku (faqja e parë) duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

- Të dhënat e universitetit logo, universiteti, fakulteti, departamenti
- Të dhënat e studentit emër, mbiemër, viti i studimit, drejtimi i studimeve
- Fusha e punimit & tema e punimit

Shkarkoni shembujt e gatshëm [KËTU](#)

4. Zhvillimi & Përmbajtja

Punimi duhet të jetë i ndarë në: hyrje, zhvillim, përfundime dhe rekomandime. Çdo paragraf duhet të ketë të paktën një referencë. Çdo faqe duhet të ketë jo më pak se tre referenca dhe mënyra e referimit duhet të jetë e njëjtë për të gjithë punimin.

5. Bibliografia

Bibliografia duhet të jetë në një faqe më vete në fund të punimit dhe nuk është pjesë e numrit total të fjalëve. Formatimi i bibliografisë duhet të jetë i njëjtë me mënyrën e formatit të referimit gjatë punimit.

Shkarkojeni materialin orientues të bibliografisë [KËTU](#)

Dorëzimi i punimit:

Punimet do të dërgohen në adresën e mëposhtme të email-it. Në konkurs do të pranohen vetëm ato punime të dorëzuara gjatë afatit të shpallur dhe nga studentë aktiv të universiteteve partnere të CleanScore.

JSTOR@CleanScore.al